

## **RUAJTJA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE TË PERSONAVE QË KËRKOJNË NDIHMË**

Sistemi EMMA në Njësinë e Koordinimit kryen ruajtjen e të dhënave të kërkesave për ndihmë duke përfshirë:

- Rregjistrimin e çdo e thirrjeje që vjen në njësinë e Koordinimit dhe thirrjet dalëse kundrejt ekipeve në terren.
- Ruajtjen në database të gjithë ngjarjeve që aktivizohen nga kërkesat për ndihmë dhe informacionit përmbajtës të tyre.
- Ruajtjen e të dhënave të misionit duke përfshirë gjendjen hap pas hapi të ambulancës, kodin e rëndesës dhe përfundimin e rastit.
- Ruajtjen e të dhënave të pacientit me të gjitha patologjitë përkatëse dhe informacionin shoqërues.
- Ruajtjen e informacionit të mbledhur nga kartela territoriale e ekipeve në terren.

Te gjitha të dhënat ruhen në databazën kryesore, janë të enkriptuara dhe të konfiguruar në mënyrë që aksesimi të kryhet vetëm nga persona të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i QKUM-së.

Sistemi ruhet me firwall të avancuar dhe filtrim të veçantë duke përdorur modelin Active-Active për të siguruar ruajtjen e të dhënave nga ndërhyrjet e jashtme, privacy dhe mos korruptimin e tyre, gjithashtu sistemi EMMA përdor modelin redundant për çdo pajisje përbërëse që të gjitha të dhënat të ruhen në rastet e defekteve të pajisjeve fizike dhe të kryhet zëvendësimi i tyre pa ndërprerë për asnjë çast përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave.

Një pjesë tjetër e rëndësishme është sistemi i veçantë Backup që ruan një kopje të të dhënave kryesore për rikthimin e tyre në rastet e problemeve madhore me serverat kryesorë të Njësisë së Koordinimit.

Përpunimi dhe nxjerra e të dhënave nga sistemi kryhet vetëm nga persona të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i QKUM-së, dhe duke loguar çdo aktivitet në sistemin EMMA, në bazë të ligjit nr..9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr.23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.